

## Buletin nga Organizata për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Gjirokastrës - GCDO

Nr . [2] [17], Prill / Qershor 2011

### 1. Trashëgimia Kulturore si motor për zhvillimin ekonomik – seminar në Meçovë të Greqisë



Në fund të majit u mbajt në Meçovë seminari i parë i projektit european EVAH, që GCDO po zbaton në bashkërendim me tre partnerë nga rajoni. Seminari me temën “Trashëgimia Kulturore – motor për zhvillim ekonomik”, mbledhi mes të tjerëve, 38 specialistë dhe punonjës të institucioneve më të rëndësishme ekzekutive qendrore dhe vendore të

trashëgimisë kulturore nga të 4 vendet pjesëmarrëse në projekt : Shqipëria, Kosova, Maqedonia dhe Greqia. Nga Shqipëria morën pjesë 10 përfaqësues nga institucione respektive në Tiranë, Gjirokastrë e Berat. Seminari përfshinte edhe një tryezë të rrumbullakët, ku u arritën konkluzione konkrete për rolin e financimit dhe investimeve në trashëgiminë kulturore, artizanat, turizëm dhe teknologjinë informative. Seminari u organizua nga Egnatia Epirus Foundation (EEF), njeri prej 3 partnerëve të GCDO në projektin EVAH. Për më shumë për projektin 18-mujor EVAH, (Vlerat Europiane në Trashëgiminë Kulturore) të financuar nga Bashkimi European, mund të shihni <https://sites.google.com/site/ipa129799/>

### 2. Roli aktiv i qytetarëve në mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore të Ndërtuar

“Roli kyç i qytetarëve në rijetëzimin e Monumenteve të Kulturës” është projekti që GCDO zbatoi muajt e fundit në Berat e Gjirokastrë, ku ndodhen rreth 1000 monumente kulture, pjesa më e madhe në pronësi private.

Projekti u mbështet nga Programi i Përbashkët i Kombeve të Bashkuara “Kultura dhe Trashëgimia për Zhvillim Shoqëror dhe Ekonomik” dhe u financua nga Fondi Spanjoll për Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit – (MDG-F). Kjo tematikë jo shumë e rrahur u trajtua përmes 2 anketimeve



ku u testua perceptimi i qytetarëve për rolin dhe bashkëpunimin e tyre me entet publike dhe biznesin në mirëmbajtjen, restaurimin dhe rijetëzimin e monumenteve të

trashëgimisë së ndërtuar. Më pas u zhvilluan edhe 2 diskutime të mëdha publike në formën e një dialogu shumëplanësh mbi këtë temë. Një udhëzues për përdorim masiv, që synon të informojë dhe të rritë e demokratizojë rolin e qytetarëve në restaurimin dhe rijetëzimin e trashëgimisë kulturore është në proces botimi.

Ky është projekti i parë i cili sjell së bashku qytetarët e dy qyteteve shqiptare që janë përfshirë në listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s dhe ndajnë të njëjtin vend në këtë listë (dhe për pasojë të njëjtin fat) . Veprimtaritë e projektit u pasqyruan gjerësisht në dy dokumentarë që u transmetuan nga media përkatëse lokale.

### **3. “Zëra të Njomë nga Qyteti i Gurtë” – e para CD profesionale me këngë isopolifonike të interpretuara nga fëmijët**

Një koncert me këngë tradicionale isopolifonike të interpretuara nga fëmijët u ndoq me interes të jashtëzakonshëm ditët e fundit në Gjirokastrë. Koncerti përurues i grupit “Obelisku” dhe albumit të tij të parë “Zëra të Njomë nga Qyteti i Gurtë”, shënoi përmbylljen me sukses të plotë të projektit “Rilidhja e brezit të ri me Trashëgiminë Kulturore përmes muzikës isopolifonike”.



Projekti i zbatuar nga mjeshtri popullor Roland Çenko me mbështetjen e GCDO-së dhe financimin e Fondacionit Vodafone Shqipëri, trajnoi për 9 muaj 14 fëmijë të moshës shkollore në interpretimin e këngës isopolifonike, që është një traditë shumëshekullore në Gjirokastrë dhe në krahina të tjera të Shqipërisë. Projekti solli për herë të parë një interpretim profesional nga fëmijët dhe një album të tyre në



cilësi profesionale që i shtohet gamës së suvenireve nga Gjirokastra. Isopolifonia shqiptare është shpallur nga UNESCO “Kryevepër e Trashëgimisë Gojore dhe jo Materiale të Njerëzimit” në vitin 2005. Tani vazhdojnë përpjekjet që grupi të vazhdojë aktivitetin dhe, nën shembullin e tij, isopolifonia, e cila rrezikon të harrohet e të humbasë, të popullarizohet tek brezi i ri i qytetit.

#### 4. “Ringjallja e Traditave të Zejeve dhe Artizanatit në Gjirokastrë”



Përfundoi me sukses të plotë projekti “Forcimi i Zejtarisë në Gjirokastrë”. 10 të rinj gjirokastritë u trajnuan në punimin e gurit dhe drurit që janë mjeshhtëritë bazë tradicionale në ndërtimin dhe restaurimin e ndërtesave karakteristike në Gjirokastrë. Ky projekt synoi të sjellë kualifikim të mëtejshëm për kërkesat në rritje të tregut lokal të punës për mjeshtra restaurues si dhe për prodhues të suvenireve. Të rinjtë e trajnuar ndihen entuziastë për dijet e fituara dhe mundësitë që ata shohin për të punuar në Gjirokastrë. Disa prej tyre do vazhdojnë së shpejti kualifikimin në kampe ndërkombëtare restaurimi. Një fletëpalosje dhe një shtesë në websajtin e GCDO shënojnë përfundimin e projektit.

Gjatë projektit u përfundua edhe një laborator i punës praktike pranë shkollës së kualifikimit profesional të Gjirokastrës, e cila do të përdoret në trajnimet e ardhshme të GCDO. Projekti i u financua nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Tiranë.

### **5. Promovimi i Gjirokastrës dhe sfidës për shpëtimin e saj**

Në vazhdim të punës së saj për promovimin e Gjirokastrës dhe përpjekjeve për shpëtimin e qendrës së saj historike, GCDO ka marrë pjesë në disa aktivitete ndërkombëtare. Si pjesë e rrjetit South East Europe Heritage Network organizata jonë morri pjesë në Kongresin e Europa Nostra, mbajtur në Amsterdam në qershor. Europa Nostra është një organizatë pan europiane që grupon organizata të trashëgimisë kulturore nga i gjithë kontinenti europian. Çdo vit ata organizojnë një konkurrim për projektet më të mira në mbrojtje të trashëgimisë kulturore. Këtë vit për herë të parë çmimi u fitua nga organizata shqiptare “E ardhmja e së Shkuarës së Shqipërisë” me një projekt restaurimi në zonën e Korçës.

GCDO u ftua në kampin veror që Universiteti i Pensilvanisë organizoi në Kotorr të Malit të Zi dhe mbajti dy leksione për sfidën në mbrojtje të Gjirokastrës, ndërsa një anëtar i stafit mori pjesë në një trajnim për zejet e restaurimit organizuar në Rumani nga Transylvania Trust. Së fundmi, GCDO u ftua të paraqesë skemën e saj inovative në bashkëpunimin me pronarët e ndërtesave historike për përdorimin apo rijetëzimin e tyre në konferencën organizuara nga ICCROM në Romë me titull “Pjesëmarrja në vendimet restauruese”. Nëse doni të dini më tepër për përvojën e GCDO-së në këtë drejtim ju lutemi na shkruani në [info@gjirokastra.org](mailto:info@gjirokastra.org).

### **6. Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) mbështet projektin e Panairit të 5-të Trashëgimisë Kulturore në Gjirokastrë. GIZ mbështet një projekt tjetër që lidhet me traditat e artizanatit**

AMSHC iu përgjigj pozitivisht aplikimit të GCDO-së për financimin e pjesshëm të panairit të sivjetshëm të artizanatit dhe trashëgimisë kulturore që do zhvillohet në Gjirokastrë në fund të shtatorit. Tani GCDO ka përqendruar përpjekjet në gjetjen e burimeve financiare lokale, sidomos nga biznesi me synimin për ta bërë të qëndrueshëm këtë aktivitet që





sivjet ka edicionin e vet të 5-të. Tashmë artizanët nga gjithë Shqipëria shprehen të gatshëm të marrin pjesë.

Këtë vit panairi do të kombinohet me një projekt tjetër të lidhur me traditat e artizanatit. Zyra gjermane e bashkëpunimit në Shqipëri GIZ pranoi të mbështesë projekt propozimin e GCDO-së për një projekt për zhvillimin e modeleve të veshjeve moderne, duke u mbështetur mbi traditat e veshjeve popullore. Projekti përfshin edhe trajnimin e 10 artizanëve lokalë, si dhe dizenjimin e ri të dyqanit të Artizanatit, që GCDO administron në Pazarin e Gjirokastrës që nga viti 2007. Ky projekt financohet nga GIZ përmes Programit për Rrjetin e Industrive Krijuese.

## 7. Një vullnetare e re Korpusit të Paqes në GCDO



Brandie Lockett – është vullnetarja më e re e Korpusit të Paqes që mbëriti muajin e fundit në Gjirokastrë. Ajo do të punojë pranë GCDO-së dhe Parkut të Antigonesë për dy vitet e ardhshëm. Brandie është nga Los Angeles në Kaliforni dhe ka punuar për 5 vjet si arkitekthe dhe urbaniste dizenjatore. “Jam shumë entuziaste që jam në Gjirokastrë dhe do punoj për ruajtjen dhe zhvillimin e traditave të saj në arkitekturë. Ndjem e nderuar që jam në Shqipëri dhe pres me padurim të bashkëpunoj me njerëzit dhe specialistët e këtushëm” - thotë Brandie. Vit pas viti GCDO ka krijuar një traditë të mirë bashkëpunimi me vullnetarët e Korpusit të Paqes, si dhe më gjerë në përpjekjet e saj për të sjellë përvoja të ndryshme ndërkombëtare në Gjirokastrë. Brandie është vullnetarja e 5-të që punon me GCDO-në vitet e fundit.

## Faleminderit !

*\*Për më shumë informacion rreth GCDO-së dhe përpjekjeve të saj në Gjirokastrë, lutemi drejtojeni drejtorit Sadi Petrela në [spetrela@gjirokastra.org](mailto:spetrela@gjirokastra.org) ose në cel 06920 78767.*